

VENDIM
Nr.662, datë 8.10.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHETETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË SË KUÇOVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Kuçovës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Kuçovës. Kjo listë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 105 (njëqind e pesë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 556 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë).

2. Pronat me numër inventari nga 370 deri në 373 dhe prona me numër 401 të vazhdojnë të përdoren nga përdoruesit aktualë, në bazë të aktmarrëveshjeve të lidhura ndërmjet tyre dhe bashkisë së Kuçovës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Ekonomisë, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Kuçovës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano